

BASHKIA DURRËS
Njësia e Prokurimit

Durrës më, 08.11.2018

Shtojcë

Njësia e Prokurimit:

Bazuar në nenin 42 të ligjit 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreu VII neni 62 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “ Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, vendos:

Shtojcë për një ndryshim të dokumentave të tenderit me objekt: “Rikonceptim dhe rikonstruksion i shkollës së muzikës Jani Kukuzeli, Durrës”, publikuar për zhvillimin e tenderit datë 26.10.2018 Ora 10:00, shtyre me shtojcë datë 31.10.2018 Ora 10:00, shtyre me shtojcë datë 05.11.2018 Ora 10:00, shtyre me shtojcë datë 12.11.2018 Ora 10:00. bazuar në shkresën e grupit të specifikimeve teknike; bëjmë ndryshimin si më poshtë:

Në, Shtojca 12

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT,

Shtohet:

Per efekt te kryerjes së punimeve në zonën arkeologjike B, kandidati/ ofertuesi duhet te kete staf shtesë me kontratë të rregullt pune për objektin në fjalë:

- ekspert të pajisur me “License zbatimi për veprimtari Arkeologjike” mbështetur në VKM nr.237 datë 23.03.2001 "Për miratimin e rregullores për administrimin e zonës arkeologjike A dhe B të qytetit të Durrësit" dhe “Rregullore mbi kriteret e ushtrimit të profesionit të arkeologut, kriteret e gërmimit, dokumentit dhe arkivimit të të dhënave dhe materialeve arkeologjike, kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të arkeologut nga individë dhe subjekte private, miratuar me Vendim Nr.2 date 30.01.2009 të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë”.

Me qëllim që të monitorohen punimet nëntokësore, për të mos patur pasoja të mundshme në arkeologji nga implementimi i projektit.

Numri i punonjësve që duhet të ketë firma në përbërje ,nga 100 do te bëhet 101 punonjës.

Gjithashtu shtohet kategoria e licences per veprimtari arkeologjike:

A1.Survey dhe sondazh arkeologjik

Data e zhvillimit të tenderit : është publikuar data 12.11.2018 Ora 10:00

Data e zhvillimit të tenderit : **do të jetë 19.11.2018 Ora 10:00**

Njësia Prokurimit